



Qeverisje e mirë për
transparencë dhe llogaridhënie
në politikë dhe qeverisje

Autorë: Dançe Danillovska, Nada Naumovska

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJES

Shkalla e hapjes së institucioneve të pushtetit gjyqësor në rajon dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtjet e këtij publikimi janë përgjegjësi e vetme e partnerëve të projektit "ACTION SEE" dhe të ekipit hulumtues dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyrojnë qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Autorë: Dançe Danillovska, Nada Naumovska

Ekipi hulumtues i Fondacionit për internet dhe shoqëri - METAMORFOZIS:
Bardhyl Jashari, drejtor
Milla Josifovska, koordinatore e projektit

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJES

**Shkalla e hapjes së institucioneve të pushtetit gjyqësor
në rajon dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

**Qëndrimet e shprehura në këtë dokument janë të autorëve
dhe nuk i pasqyrojnë pikëpamjet e donatorëve**

Shkup, korrik 2019

Hyrje

Në bashkëpunim me partnerët nga rrjeti rajonal i OJQ-ve të “ACTION SEE”, Fondacioni për internet dhe shoqëri - Metamorfozis e përgatiti studimin e politikave publike, ku e analizojmë nivelin e transparencës, shkallën e hapjes dhe të llogaridhënies së organeve gjyqësore në Ballkanin Perëndimor. Studimi është rezultat i një hulumtimi të gjerë, të bazuar në metodë shkencore, dhe është realizuar nga anëtarët e rrjetit “ACTION SEE” gjatë disa muajve të kaluar. Qëllimi i aktiviteteve tona është përcaktimi i gjendjes reale në rajon, duke e matur në mënyrë objektive shkallën e hapjes së organeve gjyqësore dhe trajtimi i rekomandimeve për përmirësimin e saj. Ai gjithashtu ka për qëllim ta përmirësojë respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë, ku shkalla e hapjes është shumë e rëndësishme.

Ne konsiderojmë se këto janë qëllimet që i ndajmë me institucionet që janë të përfshira në hulumtim.

Propozimi i politikës publike, me analizën shoqëruese, është dokumenti i tretë i tillë. Anëtarët e rrjetit, pas hulumtimit të realizuar, dhanë rekomandime edhe vitin e kaluar për ta përmirësuar shkallën e hapjes së organeve gjyqësore.

Në bazë të rezultateve të hulumtimit të realizuar në vitin 2016, janë bërë analiza që ofrojnë një pasqyrë të situatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në rajon, duke i përfshirë edhe mangësitë dhe praktikën e mira të identifikuar në këtë fushë. Duke u bazuar në këto analiza, në dy vitet e kaluara, gjegjësisht në vitin 2017 dhe 2018, u dhanë rekomandime dhe “udhërrëfyes” për t’i përmirësuar fushat specifike të përfshira në hulumtim.

Anëtarët e rrjetit “ACTION SEE”, duke e bazuar punën e tyre në gjetjet dhe rezultatet e monitorimit të parafundit, vitin e kaluar e përmirësuan dhe përshtatën metodologjinë dhe treguesit e hulumtimit pas matjeve të para në vitin 2016, duke shpresuar se informatat e reja që u mbledhën do të kontribuojnë për një cilësi më të lartë të rezultateve të projektit. Qëllimi i përdorimit të treguesve të rinj dhe të përmirësuar është shtimi i dimensioneve të reja në hulumtim dhe të kontributi më efektiv për përmirësimin e shkallës së hapjes së institucioneve në rajon.

Duke pasur njohuri paraprake, rezultate konkrete dhe analiza të shkallës së hapjes në nivel rajonal, dhe duke besuar se organet gjyqësore udhëzohen nga hapat e paraqitura për ta përmirësuar situatën në këto fusha dhe se do të punojnë për t’i përmirësuar ato, ne vendosëm të angazhohemi për një shkallë më të lartë të hapjes së organeve gjyqësore në rajon. Kështu, në dy vitet e fundit hulumtimi ynë është pasuruar me tregues që angazhohen për një standard më të lartë të transparencës proaktive.

Rezultatet tregojnë se shkalla e hapjes së institucioneve gjyqësore është pothuajse e njëjtë sikurse edhe vitin e kaluar. Gjykatat në rajon mesatarisht plotësojnë 42% të kriterëve të shkallës së hapjes, ndërsa prokuroritë 31%. Siç kemi vërejtur më herët - sfidat e reformave në proces të këtyre organeve në të gjithë rajonin, si dhe nivelin e ulët të transparencës, nuk tregojnë se po bëhen përpjekje konkrete për të përmirësuar shkallën e hapjes dhe transparencën. Shkalla e hapjes nuk është vetëm qëllimi i pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, por

edhe i nevojave të gjyqësorit për të marrë njohuri në mënyrat me të cilat mund të promovohet sundimi i ligjit dhe demokracia.¹

Duhet të ndërmerren hapa konkret dhe urgjent për të përmirësuar shkallën e hapjes së gjyqësorit në rajon, duke kontribuar kështu në forcimin e besimit të publikut në gjyqësor.

Rekomandimet tona u drejtohen vendimmarrësve në gjykata dhe prokurori në vendet e rajonit. Mund të jetë e dobishme për përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare, si dhe kolegët në sektorin e OJQ-ve që merren me këto problematika.

Shkalla e hapjes së gjykatave dhe prokurorive publike në rajon

Hulumtimi i këtij viti ka konfirmuar që ne ende nuk kemi një nivel të kënaqshëm të shkallës së hapjes në gjyqësor. Gjykatat dhe prokuroritë në rajon, mesatarisht, plotësojnë më pak se gjysmën e treguesve të hapjes. Jo inkurajues është fakti që ky rezultat është pothuajse i njëjtë me vitin e kaluar. Përkundrazi, tregon se çështja e hapjes nuk është ende në listën e prioritetëve të këtyre institucioneve.

Shumica e gjetjeve dhe rekomandimeve tona nga viti i kaluar mbeten të pandryshuara

Qytetarët përballen me vështirësi të shumta në gjetjen e informacioneve publike që i kanë në dispozicion gjykatat. Shumë gjykata në rajon nuk kanë faqet e tyre në internet, ndërsa një numër i konsiderueshëm i tyre kanë një sasi të kufizuar të të dhënave në faqet e tyre në internet. Një kufizim shtesë në qasjen në informacione është se shumë gjykata nuk japin kontakte të personin përgjegjës për kërkesat për qasje të lirë në informacione, megjithëse është detyrim ligjor.

Rreth gjysma e gjykatave në rajon nuk i 'u përgjigjën pyetësorit që ua kemi dërguar për të hulumtuar më hollësisht nivelin e tyre të hapjes. Ky në vetvete është një tregues i shkallës së hapjes të një institucioni dhe përkushtimit të tij për të bashkëpunuar me OJQ-të për këto çështje.

Në parim, proceset gjyqësore në rajon janë të hapura për publikun. Sidoqoftë, qasja në gjykatë për personat me aftësi të kufizuara është ende problematike, megjithëse ligjet i detyrojnë institucionet publike të përshtasin infrastrukturën e tyre.

Shpërndarja e rastësishme e lëndëve është thelbësore për pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Në këtë pjesë, ne e kuptuam nevojën për hapa dhe ndërhyrje specifike që duhet të çojnë në implementimin e plotë të këtij parimi. Edhe në këtë matje, kemi vërejtur probleme me publikimin e vendimeve të arsyetuara gjyqësore.

Prokuroria gjithashtu nuk ofron mundësi të mjaftueshme për qasje në informacione që duhet të jenë në dispozicion të publikut. Shqetësues është fakti që ka ende një numër të konsiderueshëm të prokurorive në rajon që nuk kanë faqet e tyre në internet. Rezultatet e hulumtimit tonë tregojnë një nivel të ulët të transparencës organizative të atyre prokurorive që kanë faqet e tyre të internetit.

1)

Partneriteti i Hapur Qeveritar, <https://bit.ly/2Ckfp81>

Një numër i konsiderueshëm i prokurorive nuk publikojnë informacione themelore për punën e tyre, siç janë të dhënat për të punësuarit, kontaktet, programet, raportet dhe të tjera. Informacionet mbi procedurat disiplinore kundër prokurorëve dhe rezultatet e tyre, shpesh nuk janë në dispozicion.

Siç kemi theksuar vitin e kaluar, shumë prokurori ende nuk kanë miratuar ndonjë udhëzues ose udhëzime për bashkëpunim dhe raportim mediatik, megjithëse kjo është shumë e nevojshme për të parandaluar rrjedhën e procedurave dhe hetimeve.

Shkalla e hapjes së gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Për vite me radhë, vlerësimet e sistemit të drejtësisë dhe sundimi i të drejtës në raportet ndërkombëtare kanë hasur një ngadalësim të reformave me vërejtje të veçanta për kapjen e shtetit dhe drejtësi selektive. Për herë të parë, Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2018 shënoi përparim të mirë në zbatimin e reformave të sistemit të drejtësisë bazuar në Strategjinë për Reforma në Sektorin Gjyqësor². Kryesisht vlerësime pozitive për pavarësinë e gjyqësorit u dhanë nga Komisioni Evropian në vitin 2019, para së gjithash, për shkak të ndryshimeve të shumta legjislative në këtë fushë, në përputhje me udhëzimet e dhëna nga prioritetet e reformave urgjente për shtetin edhe nga Komisioni i Venecias.³

Shoqëria civile jep gjithashtu notë pozitive në lidhje me transparencën e proceseve legjislative, përfshirjen e palëve dhe shoqërisë civile dhe vlerësimin e cilësisë së ligjeve dhe politikave të propozuara.⁴ Sidoqoftë, transparenca aktive e organeve gjyqësore, sipas të dhënave nga ky studim, mbetet e ulët.

Për dallim nga gjykatat në rajon, treguesit mesatarë të shkallës së hapjes patën rënie prej 4%, ndërsa gjykatat në Maqedoninë e Veriut u rritën me po aq përqindje. Sidoqoftë, shkalla e hapjes së gjykatave në Maqedoninë e Veriut vlerësohet me përqindje modeste prej 43%.

Megjithëse pritej që prezantimi i Portalit Gjyqësor në RVM (www.vsrn.mk) në vitin 2017 të kontribuonte në unifikim më të madh të transparencës së gjykatave, hulumtimi tregon ndryshime të mëdha midis gjykatave. Vlerësimi më i ulët është Gjykata Themelore e Negotinës me 30% dhe më e larta Gjykata Themelore e Strugës me 51%, ndërsa Gjykata Supreme përmbush 57% të treguesve. *Struktura e portalit gjyqësor është identike për sa i përket informacionit që duhet të publikohet nga të gjitha gjykatat në vend, kështu që Qendra e Teknologjisë së Informacionit të Gjykatës Supreme të RMV-së dhe Këshilli i Reformave Gjyqësore duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje përditësimit dhe publikimit të unifikuar të informacioneve nga të gjitha gjykatat.*

Sa i përket parimeve të transparencës, qasjes, integritetit dhe efikasitetit mbi baza të të cilave është realizuar hulumtimi, përmbushja e treguesve për integritetin e gjykatave është në nivel më të ulët, gjegjësisht gjykatat plotësojnë vetëm 35% të treguesve sepse nuk publikojnë Kodet e Etikës në faqet e tyre të internetit. Për më tepër, vetëm tre gjykata nga mostra e hulumtimit janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen nëse kanë realizuar trajnime për standardet e parandalimit të korrupsionit dhe konfliktin e interesit.

2)

Analizë për zbatimin e strategjisë për reforma në sistemin gjyqësor (2017-2022) në periudhën 2018/2019, <https://bit.ly/2nr2Vri>

3)

Raporti i Komisionit Evropian për përparimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019, <https://bit.ly/2EGrVAe>

4)

Analiza e zbatimit të strategjisë për reformën e sektorit gjyqësor (2017-2022) për periudhën 2018/2019, <https://bit.ly/2nr2Vri>

Gjykatat qëndrojnë më mirë në fushën e transparencës (50%), e cila vlerëson dispozicionin e informacioneve për vendosjen organizative, strategjitë dhe kompetencat e gjykatave dhe biografite të gjykatësve. Por gjykatat ende nuk i publikojnë pagat e gjykatësve dhe informacionet për të punësuarit në gjykata.

Qasja në drejtësi dhe në informacione me karakter publik

Qasja është një nga segmentet më të rëndësishme për vlerësimin e gjykatave. Këtu përfshihen parimet e qasjes në gjykatë, qasjes në informacione dhe publikut në seancat gjyqësore. Qasja në gjykatë vlerësohet me 48% pasi ekzistojnë standarde për përdorimin e gjuhëve të bashkësive etnike dhe ekziston një bazë e të dhënave elektronike të gjykimeve. Sipas Ligjit për Gjykatat, secila gjykatë duhet të shpallë aktgjykimet brenda 7 ditëve nga hyrja në fuqi e tyre⁵, por hulumtimi tregon përditësim të pamjaftueshme nga gjykatat gjatë publikimit të aktgjykimeve. *Prandaj, është veçanërisht e rëndësishme që Qendra për Teknologji Informatike në Gjykatën Supreme të RMV-së të sigurojë publikimin në kohë të vendimeve dhe respektimin e këtij detyrimi ligjor nga të gjitha gjykatat.*

Një dobësi në qasje është mungesa e një mekanizmi adekuat për komunikim me grupet e cenushme. Në faqet e internetit të gjykatave është vendosur person për kontakt me personat me aftësi të kufizuara, por vetë faqet nuk janë të arritshme për njerëzit me dëmtime në shikim dhe nuk janë publikuar udhëzime specifike për të drejtat e grupeve e rrezikuara. Për më tepër, gjykatat publikojnë një person përgjegjës për kontakt me mediumet dhe publikun, por nuk publikojnë udhëzime se si mediumet dhe publiku mund të komunikojnë me autoritetet gjyqësore.

Qasja në informacionet në dispozicion në faqet e internetit të gjykatave vlerësohet në vetëm 26%, pasi gjykatat publikojnë personat për kontakt për ushtrimin e të drejtës së qasjes në informacione, por ata nuk publikojnë informacione për të cilat tashmë është dhënë përgjigje, gjegjësisht kërkesa të parashtruara për qasje të lirë në informacione publike.

Efikasiteti ose njoftimi me punën e gjykatave

Standardet e monitorimit dhe vlerësimit, si pjesë e parimit të efikasitetit, janë jashtëzakonisht të rëndësishme, kryesisht sepse nëpërmes tyre, publiku fiton bindjet për funksionimin, efikasitetin dhe pavarësinë e gjykatave. Këto standarde vlerësojnë se çfarë informacionesh publikojnë gjykatat në kuadër të raporteve të tyre, gjegjësisht, nëse ato publikojnë informacione për numrin e lëndëve të iniciuara, përfundura dhe të vonuara gjatë vitit, informacione mbi ankesat e paraqitura kundër gjykatësve dhe dënimit, dhe nëse raportet janë ngritur dhe publikuar në kohë.

Në kuadër të këtyre standardeve qëndron edhe (mos) ekzistenca e një sistemi automatik të shpërndarjes së çështjeve. Gjykatat në Maqedoninë e Veriut plotësojnë vetëm 41% të standardeve të deklaruara dhe ato duhet të përmirësohen kryesisht në drejtim të publikimit me kohë të raporteve gjyqësore në portalin e vetëm gjyqësor. Gjithashtu, *përkundër faktit se në RMV është vendosur Sistemi Automatizuar Kompjuterik për Menaxhimin e Lëndëve, aplikimi i tij duhet të monitorohet vazhdimisht për të kapërcyer dhe shmangur abuzimet e sistemit, të identifikuar në një raport të veçantë të vitit 2017.*⁶

5)

Ligji për Gjykatat, neni 89

6)

Raport nga kontrolli i realizuar për funksionalitetin e sistemit të informacionit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave nga Rregullorja e punës së gjykatave <https://bit.ly/2oeN67i>

Këshilli Gjyqësor i RMV-së

Këshilli Gjyqësor gjatë dy viteve të kaluara ka parë një nivel identik të shkallës së hapjes, pas një rënie të konsiderueshme në përbushjen e treguesve të transparencës me 15% në 2017. Kështu, në vitin 2017 dhe 2018, Këshilli Gjyqësor plotësoi 43% të treguesve, që është një rënie në krahasim me ato të matjeve paraprake të vitit 2016. Parimi i dispozicionit së Këshillit Gjyqësor është akoma më i ulëti me 28%. Kjo kryesisht për shkak se Këshilli Gjyqësor nuk ka kanale të mira për komunikim me qytetarët dhe mediat. Nuk ka udhëzues për paraqitjen e ankesave nga qytetarët përmes portalit në internet dhe nuk ka udhëzues për media.

Parimi i transparencës është gjithashtu i ulët, me 37% të treguesve që janë përbushur. Këshilli Gjyqësor është i mirë vetëm për sa i përket informacionit në dispozicion për strukturën organizative (64%), ndërsa i vlerësuar me 0% për mungesë të politikave të prokurimeve publike dhe mos zbulimit të informacioneve të lidhura me prokurimet publike.

Këshilli Gjyqësor, të paktën në kuptimin formal, përbush në mënyrë të kënaqshme treguesit e pavarësisë me 76%, pasi Kushtetuta e përcakton atë si një organ të pavarur; ekzistojnë kritere ligjore për zgjedhjen e gjykatësve; ka buxhetin e vet dhe kontrollin administrativ mbi Gjykatën Supreme.

Shkalla e hapjes së prokurorive në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Rezultatet e Prokurorisë Publike si pjesë e sistemit të drejtësisë janë në një nivel jashtëzakonisht të ulët, duke përbushur vetëm 4% të treguesve të hapjes, që është 5% më i ulët se rezultatet e vitit 2017. Prokuroritë Themelore dhe të Larta ende nuk kanë faqet e tyre të internetit dhe së bashku plotësojnë vetëm 4% të treguesve ndërsa Këshilli i Prokurorëve Publik vetëm 32%.

Prokuroria e RMV-së është e vendosur në mënyrë hierarkike si autoriteti më i lartë mbi Prokuroritë e Lartë dhe Themelore dhe informacionet e mangëta rreth tyre publikohen vetëm në faqen e asaj prokurorie.

Prokuroria nuk i ka marrë parasysh rekomandimet e këtij hulumtimi, të cilat synojnë që Prokuroritë Themelore dhe të Larta të posedojnë faqet e tyre në internet, ose faqja e vetme (e përbashkët) të plotësohet me informacione nga Prokuroritë e Larta dhe Themelore.

Këshilli i Prokurorëve Publikë plotëson 32% të treguesve të shkallës së hapjes, që është një rritje prej 12% në krahasim me vitin 2017 kur janë përbushur 20%. Këshilli për vitin e dytë me radhë ka vlerësimet më të ulëta për qasje pasi plotëson vetëm 11% të treguesve të qasjes pasi publikon vetëm vendimet e marra nga organi. Këshilli vlerësohet me 0% për treguesit e prokurimeve publike.

Ashtu si në rastin e Këshillit Gjyqësor, Këshilli i Prokurorëve Publikë, të paktën në mënyrë formale, plotëson disa nga treguesit e pavarësisë (41%), pasi ekzistojnë kritere ligjore për zgjedhjen e prokurorëve ndërsa ka edhe buxhetin e vet.

Metodologjia e hulumtimit

Hapja është kusht kryesor për demokracinë pasi që u mundëson qytetarëve t'i marrin informatat dhe njohuritë e nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendimmarrjen efikase dhe përgjegjësinë e institucioneve për politikën që i zbatojnë. Institucionet në gjithë botën ndërmarrin aktivitet konkretë për ta rritur transparencën dhe llogaridhënien e tyre ndaj qytetarëve. Për ta përcaktuar shkallën në të cilën qytetarët e Ballkanit Perëndimor marrin informata në kohë dhe të kuptueshme nga institucionet e tyre, u zhvillua një indeks rajonal i shkallës së hapjes.

Indeksi rajonal i shkallës së hapjes e mat shkallën në të cilën institucionet e Ballkanit Perëndimor janë të hapura për qytetarët dhe shoqërinë, duke u bazuar në katër parime: (1) transparencën (2) qasja (3) integriteti dhe (4) efikasiteti.

Parimi i transparencës nënkupton se informacionet e organizatës, buxheti dhe procedurat për furnizim publik janë në dispozicion dhe se publikohen. Qasja ka të bëjë me sigurimin dhe respektimin e procedurave për qasje të lirë në informata dhe rritjen e qasjes në informata përmes mekanizmit të debateve publike dhe forcimit të bashkëveprimit me qytetarët. Integriteti përfshin mekanizma për parandalimin e korrupsionit, zbatimin e Kodeve etike dhe rregullimin e lobimit. Parimi i fundit, efikasiteti, ka të bëjë me monitorimin dhe vlerësimin e politikave që i zbatojnë institucionet. Duke i ndjekur standardet, rekomandimet dhe shembujt ndërkombëtarë të praktikës së mirë, këto parime janë përpunuar më tej përmes treguesve specifikë sasiorë dhe cilësorë që vlerësohen në bazë të disponueshmërisë së informatave në ueb-faqet zyrtare të institucioneve, cilësinë e kornizës ligjore për çështje individuale, burimeve të tjera të informatave me karakter publik dhe pyetësorëve për institucionet.

Matja është realizuar nga dhjetori i vitit 2018 deri në fund të marsit të vitit 2019. Mbledhja e të dhënave u pasua nga një proces i verifikimit të të dhënave, duke rezultuar me një gabim standard prej +/-3%. Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit, zhvilluam një sërë rekomandimesh dhe udhëzimesh për institucionet.

Fondacioni për internet dhe shoqëri - Metamorfozi është fondacion i pavarur, jopartiak dhe jofitimprurës me seli në Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut. Misioni i Fondacionit Metamorfozis është të kontribuojë në zhvillimin e demokracisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës përmes zbatimit inovativ dhe shpërndarjes së njohurive. Vlerat tona kryesore janë transparenca, barazia dhe liria.

Fushat programore në të cilat vepron Fondacioni Metamorfozis janë:

- mediat për demokraci
- edukimi për inovacione
- përgjegjësia shoqërore
- të drejtat e njeriut në internet

ActionSEE është rrjet i organizatav qytetare që punojnë së bashku për të promovuar dhe siguruar llogaridhënie dhe transparencë të qeverive në rajonin e Evropës Juglindore, duke e rritur potencialin për aktivizëm qytetar dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, duke i promovuar dhe duke i mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut në internet dhe duke i ngritur kapacitetet dhe interesat e organizatave qytetare dhe individëve në rajon që përdorin teknologji për ta promovuar demokracinë.

Metamorphosis Foundation

address: ul. "Apostol Guslarot" 40, 1000 Skopje, N.Macedonia

e-mail: info@metamorphosis.org.mk

tel: +389 2 3109 325

www.metamorphosis.org.mk

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

347.96/.99:005.332.5(497.7)(047.31)

347.96/.99:005.332.5(497-15)(047.31)

DANILLOVSKA, Daņe

Shkalla e hapjes së institucioneve të pushtetit gjyqësor në rajon dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut : rekomandime për përmirësimin e gjendjes / autorë Daņe Danillovska, Nada Naumovska. - Shkup : Metamorfozis, 2019. - 14 стр ; 25 см

ISBN 978-608-263-022-9

1. Naumovska, Nada [автор]

а) Судство - Транспарентност - Македонија - Истражувања б) Судство - Транспарентност - Западен Балкан - Истражувања

COBISS.MK-ID 111680522

